



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 24 SHTATOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 20.09.2018 *(neni 44 i Rregullores)*.

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*.

3. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*.

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të

livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Të bartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)

7. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores).

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta.

Gramoz Ruçi – Të futet media brenda.

Fillojmë seancën.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

A ka vërejtje lidhur me procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Nga Këshilli i Ministrave është depozituar në Kuvend për ratifikim një marrëveshje financimi me Komisionin Europian. Të gjitha materialet do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Fillojmë me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. A ka pyetje? Nuk ka.

A dëshiron ta marrë fjalën ministri nismëtar? Nuk është.

Për këtë projektligj janë regjistruar për të marrë fjalën deputetët: Besnik Baraj, Ismet Beqiraj dhe, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Eduard Shalsi.

Fjalën e ka zoti Baraj.

(Reagim nga salla pa mikrofon)

Zoti Beqiraj, mund ta merrni fjalën.

Ismet Beqiraj – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Atdheu nuk mund të ketë pavarësi dhe përparim pa bukë dhe pa naftë. Diskutimin tim në këtë seancë, lidhur me saktësimin që

propozohet të bëhet në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, do ta filloj me këto fjalë filozofike të shkencëtarit të industrisë së naftës dhe të gazit, të profesor doktor Alfred Frashërit, në përvjetorin e 100-të të naftës shqiptare.

Spektori i energjisë në Shqipëri është identifikuar si një nga sektorët e rritjes strategjike, i cilësuar shpesh edhe si nxitës i rimëkëmbjes ekonomike të vendit. Në sektorin e energjisë janë zbatuar një sërë reformash gjatë periudhës së kaluar dhe vazhdojnë me intensitet edhe nga maxhoranca aktuale qeverisëse. Megjithatë, mbeten ende për t'u bërë përpjekje të konsiderueshme, sidomos në fushën e gazit natyror, me qëllim transportin dhe gazifikimin e vendit.

Spektori i gazit natyror, si pjesë e rëndësishme e strategjisë energjetike për zhvillimin ekonomik dhe industrial të vendit, projektohet të gjenerojë benefite të pazëvendësueshme për zhvillimin e sektorit të ndërtimit, sipas parimit të eficiencës së energjisë; për zëvendësimin dhe kursimin total të energjisë aktuale, si energji elektrike, dru, nënprodukte naftë, qymyr etj, për nevoja komunale dhe rezidenciale; për prodhimin e energjisë elektrike me kosto të pranueshme, pas asaj hidrike; për zhvillimin e industrisë kimike dhe asaj të plehrave azotikë; për mbështetjen e agroturizmit dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë; për zhvillimin e sektorit të industrisë, asaj ushqimore në veçanti; për zhvillimin e industrisë së përpunimit të thellë të naftës dhe asaj petrokimike.

Konsolidimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional, që rregullon sektorin e gazit dhe sektorin e energjisë në tërësi, si dhe forcimi i institucioneve përkatëse në këtë fushë janë jo vetëm objektiva të kësaj maxhorance, por janë politikat më të mira për zhvillimin e afërt dhe në perspektivë të këtij asemi të rëndësishëm energjetik me përfitime dhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Shqipëria, si palë kontraktuese e traktatit të KE-së, ka obligime ligjore rregullatore ndërkombëtare për të harmonizuar kuadrin e saj ligjor me atë të BE-së. Me fjalë të tjera, pavarësisht nga statusi i vendit në raport me procesin e integrimit në BE, sektori i gazit është i detyruar tashmë ta miratojë kuadrin rregullator

teknik të gazit në përputhje me afatet kohore të zbatimit të përcaktuara nga Komuniteti i Energjisë dhe në përputhje me dispozitat e traktatit të KE-së.

Sipas të dhënave zyrtare, Shqipëria aktualisht disponon rezerva të kufizuara të gazit natyror dhe nuk ka ende akses në tregjet ndërkombëtare të gazit natyror të prodhuar në vend. Në varësi të rezultateve të eksplorimit të institucioneve përgjegjëse, 5-10 vjetët e ardhshëm të zhvillimit të TAP-it, Shqipëria do ta marrë në konsideratë më konkretisht mundësinë e shfrytëzimit dhe transportimit të gazit natyror. Gjithashtu, paralelisht Shqipëria duhet të marrë në konsideratë edhe shpërndarjen e gazit natyror në të gjithë vendin.

Në të kaluarën Shqipëria ka pasur një sektor të rëndësishëm të gazit natyror me 7 vendburime, nga të cilat 6 vendburime të gazit natyror dhe 1 të gazit kondensat në Delvinë. Tashmë nuk ka asnjë burim gazi aktiv prodhues. Prodhimi i gazit ka rënë nga 1 miliard metër kub në vitin 1982 në 0, 01 miliard metër kub në vit gjatë viteve të fundit.

Qeveria e qokave të opozitës së sotme, pas humbjes së dhimbshme dhe lotuese në zgjedhjet e qershorit të vitit 2013, gjatë periudhës transitore të dorëzimit të pushtetit korrik-shtator 2013 gostiti oligarkun e saj, kompaninë fantazmë, të ashtuquajtur "Phoenix Gas", të përfaqësuar nga zoti Neim Kasaj, me të gjitha vendburimet e gazit natyror, Divjakë, Povelç, Frakull, Panaja, duke përfshirë edhe atë të gazit kondensat në Delvinë. Kompania koncesionare në fjalë jo vetëm që nuk realizoi investime të reja për rritjen e prodhimit të gazit natyror dhe atë kondensat në përputhje me detyrimet kontraktuale, por solli mbylljen e menjëhershme të pak puseve që ishin aktive në prodhimin e gazit, duke kryer një krim industrial dhe ekonomik. Pas kalvarit ligjor dhe procedural të qeverisë së tanishme me këtë kompani, në maj të vitit 2017 vendburimet e gazit kaluan përsëri në administrimin e Albpetrolit, por periudha e gjatë e qetësisë së puseve aktive të gazit për shkaqe shkencore dhe specifike, karakteristike e vendburimeve tona të gazit natyror dhe prezenca e ujit shtresor në trungun e pusit, bëri që pusët aktive ekzistuese të bien në avari të pakthyeshme. Ato nuk mund të aktivizohen dhe të gjenerojnë prodhim gazi. Sot prodhimi i gazit

natyror në vendin tonë është pothuajse zero. Tashmë me fillimin e zbatimit të projektit TAP, edhe industria e gazit ka filluar të futet në shinat e një zhvillimi intensiv dhe strategjik, që do të çojë në mënyrë të natyrshme integrimin e rrjetit të transmetimit të gazit në vendin tonë me atë europian.

Rinegociimi i marrëveshjes së vitit 2011 të qeverisë "Berisha" nga qeveria "Rama" me TAP për përfitimet e shtetit shqiptar nga kalimi i TAP-it në territorin tonë bëri që fitimet në buxhetin e shtetit nga 60 milionë dollarë në vit të shkojnë në 88,1 milionë euro në vit. Po kështu, është nënshkruar marrëveshja me TAP AG për mirëmbajtjen e segmentit shqiptar të TAP-it, që nuk ishte fare në marrëveshjen e vitit 2011.

Impakti i marrëveshjes së rinegociuar është në terma shumë pozitivë për qindra teknike dhe inxhinierë të naftës në vendin tonë që të kenë më shumë mundësi punësimi dhe eksperience, për rritje të performancës së kompanisë shtetërore "Albgaz sh.a" dhe për integrimin dinjitoz në rrjetin europian të gazit etj.

Kërkesa totale e parashikuar për energji termike në familje, në shërbime dhe në industri në Shqipëri, që mund të mbulohen nga përdorimi i gazit natyror, duke përfshirë bujqësinë dhe transportin, është rreth 2167 milionë metër kub në vit. Kjo parashikohet për një të ardhme jo shumë të largët, që është viti 2020. Kjo sasi do të shpërndahet sipas prefekturave dhe më tej sipas njësive administrative vendore të Shqipërisë, kurse potenciali i konsumit të gazit natyror për prodhimin e energjisë elektrike mund të jetë rreth 770 milionë metër kub në vit në vitin 2040 dhe konsumi i gazit natyror për rafineritë e naftës në vitin 2040 mund të jetë 89 milionë metër kub.

Faktorët që nxisin rritjen e kërkesës dhe shkallën e penetrimit të gazit në të ardhmen do të jenë dendësia e popullsisë dhe shpërndarja e saj, niveli i urbanizimit, lloji i banesës, si dhe prania e konsumatorëve spiralë industriale.

Lidhja me TAP-in, që pritet të ndodhë jo më herët se viti 2020, dhe zbulimet e pamundshme të gazit brenda vendit do të përcaktojnë në vijim specifikat e tregut të gazit natyror në Shqipëri. Prandaj përgatitja e akteve ligjore në këtë fushë është parë si prioritet. Kuadri ligjor dhe rregullator për tregun e gazit në Shqipëri aktualisht është i përcaktuar në ligjin për sektorin e gazit natyror të vitit 2015, i cili u

miratua nga parlamenti shqiptar më 23 shtator 2015. Me ligjin për sektorin e gazit natyror të vitit 2015 Shqipëria ka transpozuar detyrimet që dalin nga paketa e tretë e energjisë, direktiva 2009/73/KE dhe rregullorja e KE-së nr. 715/2009 për legjislacionin e BE-së.

Rregullat teknike për industrinë e gazit

Në zbatim të ligjit nr. 102, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror” deri tani janë miratuar 27 rregulla teknike dhe vazhdon puna edhe për 34 rregulla të tjera teknike, për të cilat përgëzojmë personelin dhe specialistët e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për sa më sipër, me anë të këtij projektligji propozojmë ndryshim dhe saktësim të formulimit të fjalisë së parë të pikës 2 të nenit 89 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, duke e përshtatur atë plotësisht me përmbajtjen e vetë nenit 89 të ligjit, që ka si objekt vendosjen e detyrimit të shërbimit publik në veprimtaritë që lidhen me transmetimin, me shpërndarjen dhe furnizimin me gaz natyror. Për këto arsye, në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” kërkohet që fjalia e parë e pikës 2 të nenit 89 të ligjit të formulohet: “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”. Me miratimin e këtij ndryshimi bëhet i mundur vazhdimi i mëtejshëm i procedurave për përgatitjen dhe miratimin e akteve të tjera ligjore dhe nënligjore nga Këshilli i Ministrave.

Së fundi, shpreh keqardhjen për opozitën, e cila mungon përsëri, duke braktisur vendin e punës, për të cilin sovran i ka mandatuar. Nëpërmjet vetëpërgjashtimit kokëfortë ajo jep modelin dhe shembullin më të keq në këto momente që po kalon kombi shqiptar, në prag të realizimit të reformave dhe ëndrrës së kahershme europiane.

Duke vlerësuar rëndësinë e ndryshimeve dhe saktësimit që propozohet në këtë nen të ligjit, ju ftoj ta miratojmë pa vonesë.

Gramoz Ruçi – Ju faleminderit, zoti Ismet Beqiraj!

Fjalën e ka zoti Besnik Baraj.

Besnik Baraj –Faleminderit!

Unë nuk dua të ndalem te projektligji në fjalë, sepse bëhet fjalë për një ndryshim të vogël dhe është fare i qartë, por dua të sjell për ju dhe

opinionin publik mbresat e një vizite që kemi bërë në kompaninë TAP.

Nga pikëpamja inxhinierike dhe respektimi i kuadrit ligjor në mbrojtje të mjedisit, aty po kryhet një punë e jashtëzakonshme dhe impresionuese. Mbresëlënëse ishin cilësia dhe standardet, me të cilat operonte i gjithë kantieri. Kërkesat rigorozë për shëndetin e punonjësve ishin kryesore. Atje ishin të evidentuara të gjitha rastet e aksidenteve, duke nisur nga ato më të voglat, që aq shpesh mund të ndodhin në ndërmarrje të tjera, por që nuk vlerësohen, madje klasifikohen si incidente dhe aksidente.

Që kur hipëm në mikrobuz dhe në makina, mjetet ishin të detyruara të respektonin shpejtësinë e lejuar me ligj, e cila kontrollohej nga një pajisje e vendosur nëpër makina dhe nëpërmjet një zyre qendrore. U ngjitëm në pikën më të lartë, 2100 metra, Qafa e Martës, ku tashmë na shoqëronte linja e tubave, aty ishte edhe pjerrësia më e madhe e tubave, 44 gradë. Në kantier 85% e punonjësve ishin shqiptarë.

Ajo që unë dua të theksoj është se këto vepra kanë një vlerë të jashtëzakonshme ekonomike, por edhe profesionale. Është e pafalshme nga ana jonë që të na shpëtojnë këto mundësi të mëdha shkollimi për të krijuar dhe për të zhvilluar kapacitete teknike dhe profesionale. Për këtë duhet një bashkëpunim i Ministrisë së Energjetikës me atë të Arsimit dhe me rektoratet e universiteteve përkatëse, të cilat mbulojnë fushat e përfshira në këtë aktivitet kaq të madh, por pa dyshim edhe me sipërmarrësit e TAP-it, në mënyrë që të kenë një marrëveshje, përvojë dhe trajnim të studentëve për problematika të ndryshme. Do të ishte shumë me vlerë që këto punime, duke u shoqëruar edhe nga stafi akademik, të ishin produkte temash diplome, punime masteri dhe tema doktoraturash.

Punimet e TAP-it janë shoqëruar me analiza të shumta gjeologjike dhe kimike, të cilat janë një pasuri e madhe shkencore, që duhet dhe do të ishte mirë të përvetësoheshin nga mjediset akademike shqiptare.

Ne pyetëm nëse kjo kompani ka lidhje me universitetin dhe na thanë se ka me Politeknikun, por unë kam frikë se aspekti sasior i këtij bashkëpunimi është në përmasa modeste në raport me mundësinë që na ofron puna e TAP-it për sa i përket cilësisë teknike dhe inxhinierike.

Unë gjykoj se puna e bërë nga TAP-i mund të shërbejë si një model i delikatesës së ndërhyrjes në mjedis nga kompanitë shqiptare.

Është rasti të shtoj se disa kompani, të mbështetura edhe nga politika, si ajo që operon në Valbonë, me ndërhyrje tejet agresive, duke mos respektuar asnjë ligj të mbrojtjes së mjedisit, duhet të mësojnë sesi punohet në TAP dhe si respektohen ligjet për mbrojtjen e jetës së punëtorëve dhe standardet për të mos dëmtuar mjedisin.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Baraj!

Këtu mbyllim diskutimin për projektligjin “Për sektorin e gazit natyror”.

Kalojmë në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave, që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar”.

A dëshiron të marrë fjalën ministri nismëtar i këtij projektligji?

Janë regjistruar për të diskutuar për këtë projektligj deputetët: Klotilda Bushka, Vullnet Sinaj, Elisa Spiropali, Taulant Balla, Andrea Marto, Bujar Çela në emër të grupit dhe Fadil Nasufi.

Fjala për zotin Vullnet Sinaj. Pastaj fjalën e ka zonja Klotilda Bushka.

Vullnet Sinaj – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar shqiptarë që na ndiqni,

Sa herë mendoj të marr fjalën në parlament dhe shikoj që opozita nuk merr pjesë, aq herë mendoj se kujt ia keni besuar votën. Parlamenti dhe Shqipëria nuk kanë nevojë vetëm për maxhorancën, por edhe për opozitën dhe për mendimin saj në parlament. Edhe ne si maxhorancë kemi nevojë për opozitën, në mënyrë që së bashku të bëjmë më të mirën për këtë vend. Nuk mund të diskutojmë ligje pas ligjesh në parlament dhe opozita të mungojë.

Sot po diskutojmë një ligj shumë të rëndësishëm, i cili ka të bëjë me tokat bujqësore, me ndërtimet në tokat bujqësore, të dhëna me qira, për të zhvilluar bujqësinë në Shqipëri, ku dihet se një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve e kanë mbështetur të ardhmen e tyre në ekonominë bujqësore, ndërsa opozita vazhdon të shohë përsëri interesat e saj duke mos menduar asnjëherë për ata përfaqësues, të cilët e

kanë votuar dhe i kanë dhënë votën për të qenë në këto karrige, që po vazhdojnë t'i lënë bosh. Ky është vërtet një turp i madh për opozitën, por ajo po i shkakton një dëm të madh Shqipërisë dhe kombit.

Dua t'u them deputetëve të opozitës, të cilët i pashë në televizor, se kishin bërë një vizitë në qytetin tim, në Vlorë, dhe u mjaftuan me sallën e selisë së Partisë Demokratike për të bërë mbledhjen: e kishit shumë afër Lungomaren, pse nuk dolët të bënit një vizitë për të parë se çfarë ka bërë atje qeveria “Rama”? Pse nuk dolët për të parë sesi e ka bërë Vlorën dhe e ka afruar atë me Europën, por merreni vetëm me kronikat e zeza dhe vazhdoni ende të ngjallni pasiguri në Shqipëri? Shumë afër Vlorës është edhe Bashkia e Selenicës, pse nuk shkuat atje dhe të njiheshit me problemet e banorëve të zonës? Nuk e keni marrë vesh ende se në zonën e Smokthinës, në muajin maj ka rënë një tërmet, i cili ka prekur fshatrat Vermik, Bashaj dhe Matogjin dhe ka shkaktuar dëme. Nuk shkuat të merrnit vesh se në Kocul ka pasur rrëshqitje të dheut dhe ka shkaktuar dëme të shtëpive të banorëve atje. Pse nuk shkuat të bashkëpunonit me atë bashki, sepse është juaja? Akoma nuk është mbledhur këshilli bashkiak për të marrë një vendim për dëmshpërblimet dhe sistemimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti. Ngelët brenda selisë së partisë suaj dhe nuk dolët në terren të takonit njerëz. Dua t'ju them se duhet të kuptoni se çfarë detyrimesh keni për atë popull, i cili ju ka dhënë një pjesë të votave dhe karriget në parlament. Detyrohem të flas kështu, pa pjesëmarrjen tuaj, dhe nuk jam i nderuar që po e bëj, sepse duhet të ishit këtu të më dëgjoni.

Ligji që po diskutojmë sot, për dhënien e tokave bujqësore me qira, është i vitit 1998. Qeveria “Rama” dhe Ministria e Bujqësisë lejojnë ndërtimin e objekteve me qëllim zhvillimin e prodhimeve bujqësore të këtyre tokave, duke u dhënë mundësinë fermerëve që t'i konfeksionojnë dhe t'i ruajnë ato, duke shtuar vlerat e prodhimeve bujqësore në këto toka bujqësore, me qëllim rritjen e vlerës së tyre në treg, por njëkohësisht edhe për të pasur një rritje ekonomike të atyre zonave dhe punësimit të njerëzve atje. Unë mendoj se ky ligj me shtesën e tij duhet miratuar pa asnjë hezitim.

Dua të ndalem edhe në disa probleme të tjera, për të cilat jemi të detyruar të bëjmë edhe

ndonjë autokritikë, por edhe ndonjë kritikë. Meqenëse nuk ka kush t'i bëjë këto kritika, do t'i bëjmë vetë. Unë për të disatën herë në fjalimet e mia, këtu në parlament, vazhdoj të përsëris problemin e certifikatave të pronësisë së tokave bujqësore në zonat rurale. Ky është një problem shumë i rëndësishëm dhe nuk duhet të na vijë zor që të themi se cila është situata reale sot në Shqipëri. Si një njeri i ardhur nga ekonomia e tregut, nuk mund ta kuptoj dot bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik të bujqësisë në zonat rurale pa një ekonomi tregu, pa një certifikatë pronësie, pa shitblerjen e tokës apo dhënien me qira të saj sipas rregullave. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me ne si maxhorancë, por edhe me opozitën, e cila sot mungon. Të gjithë së bashku duhet të kemi dëshirë për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare këtij problemi, sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm për situatën reale në Shqipëri. Në zonat e Veriut toka nuk është ndarë sipas ligjit nr. 7501, por e kanë marrë ish-pronarët, ndërsa në Jug dhe në Shqipërinë e Mesme ka funksionuar ligji nr.7501, por edhe atje ligji nr.7501 nuk është zbatuar siç duhet, sepse fermerët kanë ngelur pa certifikata pronësie ose nuk kanë aktet e marrjes në pronësi të tokës. Këto probleme kanë sjellë edhe pasoja të tjera. Edhe pse qeveria "Rama" ka marrë masa për të subvencionuar bujqësinë, fermerët dhe blegtorët në zonat rurale kanë pasur pengesa të mëdha. Edhe pse në zonën time, në Bashkinë e Selenicës, ka pasur rreth 110 fitues në fazën e parë të konkurrit për subvencionet në bujqësi, kjo nuk ka ndodhur në fazën tjetër të përfitimit direkt të vlerave monetare nga këta fermerë apo nga këta blegtorë dhe kjo si pasojë e dokumenteve të pronësisë së tokës. Në udhëzimet e Agjencisë thuhej se fermeri duhet të ketë një tokë ose me rreth 5 dynymë të bashkuar, ose deri në 1 hektar, që të përfitojë subvencionin. Si mund ta realizojmë një gjë të tillë dhe t'i japim mundësi fermerit të investojë, kur toka, sipas ligjit nr. 7501, është ndarë me copa dhe ai e ka të vështirë të bashkojë 5 dynymë?! Edhe brenda familjes certifikata është dhënë në emër të kryefamiljarit, i cili duhet të marrë pëlqimin e anëtarëve të familjes me dokumente dhe noter. Si mund të firmosë dokumentin djali, që e ka në Itali ose në Gjermani, në mënyrë që fermeri të përfitojë subvencionet?! E njëjta gjë ndodh edhe me fermat bujqësore, që kërkojnë deri në 1

hektar tokë dhe u duhet të bashkojnë dy pesë dynymë.

Të nderuar kolegë, këto janë probleme shumë të rëndësishme për bujqësinë dhe tokat bujqësore, për të cilat duhet të shqetësohemi jo vetëm ne si maxhorancë, por edhe opozita, e cila mungon dhe nuk merret vesh se ku është sot, çfarë po bën dhe me çfarë po merret. Unë di vetëm një gjë, që kjo opozitë nuk merret me problemet dhe hallet e shqiptarëve dhe nuk e ka ndër mend të merret. Ajo ka vetëm hallin e saj, që i ka krijuar vetingu në drejtësi dhe po rend çdo ditë për të zgjidhur atë problem. Se çfarë halli ka fermeri shqiptar dhe blegtori shqiptar, opozita nuk do t'ia dijë. Kështu që, të nderuar kolegë, na takon neve t'i bëjmë të dyja punët, edhe atë të opozitës, edhe atë të pozitës.

Të më mirëkuptojë ministri i Bujqësisë, por unë jam i detyruar të shpreh këto mendime, sepse janë mendimet e njerëzve të thjeshtë, të atyre banorëve të zonave të mia, që punojnë çdo ditë për të rritur mirëqenien e tyre, por që kanë mungesa, të cilat, me dashamirësinë tonë këtu në parlament, mund t'ua zgjidhim.

Gjej rastin të them se po bëhet një punë e dobët nga ana e drejtorive bujqësore, në përgjithësi, dhe se duhen shkundur nga plogështia dhe nga gjumi. Më duket se po vazhdojnë rrjedhën e pjesës së parë të qeverisë "Rama", ku Ministria e Bujqësisë nuk pati rezultate dhe po bëhen pengesë për zbatimin e programit të ri të kësaj qeverie. Prandaj, dua t'i bëj thirrje nga ky parlament ministrit që të marrë masa e të shkundë drejtoritë e bujqësisë, sepse, po të jenë në pozita pune, mund të sjellin më shumë informacion në qendër, mund të bëjnë më shumë propozime për t'i ndryshuar dhe për t'i rregulluar të gjitha problematikat që kanë sot fermerët, si, për shembull, problematikat që kanë fermerët që kanë banuar në ish-fermat shtetërore, të cilët kanë ngelur pa e marrë aktin e pronësinë së tokës për arsye se kanë ndryshuar vendbanim. U bënë 27 vjet që bëhen ligje pas ligjesh dhe njësitë bashkiake mund t'i kishin ndihmuar për t'i marrë këto dokumente.

Sot gjej rastin t'u bëj thirrje të gjithë fermerëve shqiptarë se kanë afat deri më 31 dhjetor të shkojnë pranë bashkive për të marrë aktin e pronësinë së tokës. Të gjithë fermerët që nuk e kanë marrë të nxitojnë sa më shpejt, sepse toka është e shenjtë dhe prona është e shenjtë.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 24 SHTATOR 2018

Është ajo që do ta çojë përpara zhvillimin ekonomik jo vetëm të zonave rurale, por edhe të Shqipërisë. Kjo është shumë e rëndësishme.

Ju ftoj të gjithë ta votojmë këtë ligj. Le të jetë ky ligj që u hap rrugën ligjeve të tjera që do të votohen në këtë parlament në të mirë të fermerëve.

Faleminderit!

(Drejtimit e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Sinaj!

Fjalën e ka ministri Niko Peleshi.

Të përgatitet deputetja Klotilda Bushka.

Niko Peleshi - E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Siç e tha edhe kolegu ynë, zoti Sinaj, ky është një ligj i rëndësishëm. Në fakt, ligji “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar,” i cili është miratuar në vitin 1998, nuk është një ligj i ri. Te ky ligj ne kemi bërë disa rregullime, në dukje të vogla, por me impakt shumë të madh. Në bazë të ligjit në fuqi, kemi një handikap në lidhje me të gjithë investitorët që në vite kanë marrë apo vazhdojnë të marrin toka bujqësore me qira nga Ministria e Bujqësisë apo nga bashkitë. Kujtoj se është një sasi prej rreth 80 mijë hektarësh në total, ku 20 mijë të së cilës i përkasin Ministrisë së Bujqësisë, një pjesë janë kontraktuar, pjesa më e madhe prej rreth 15 mijë hektarësh janë të shpallura, por të pakontraktuara, ndërsa pjesa tjetër u takon bashkive, pra i nënshtrohet procesit të qiradhënies nga bashkitë. Në të dyja këto raste të gjithë qiramarrësit, ndonëse e fitojnë kontratën e qirasë mbi bazën e një plani biznesi për të zhvilluar një ekonomi bujqësore, një fermë, si dhe kanë facilitetet e nevojshme për magazinimin, për ruajtjen apo për përpunimin e tyre, në bazë të ligjit në fuqi, nuk lejohen t’i zhvillojnë ato kur toka është e marrë me qira. Ne bëjmë pikërisht këtë rregullim. Në respekt të legjislationit dhe planeve të përgjithshme vendore të miratuara nga bashkitë, u japim mundësinë, në fakt, duket logjike, por ka qenë e penguar nga ligji, sepse jo të gjitha ligjet janë logjike, të zhvillojnë brenda këtyre destinacioneve, pa i ndryshuar ato për asnjë arsye, sepse këtë e sanksionon ligji, struktura në mbështetje të fermës bujqësore. Ky është një çlirim shumë i madh për dhjetëra e dhjetëra

kontrata, të cilat sot janë në ngërç dhe janë pas derës së Ministrisë së Bujqësisë apo bashkive.

Në këtë ligj kemi sanksionuar se për këto investime që qiramarrësi kryen dhe i zhvillon në vite, të mos kërkohet në fund të kontratës kompensim nga shteti, sepse do të rezultnim me një faturë shumë të madhe, të papërballueshme dhe më pas do ta fuste procesin e kthimit të tokës së marrë me qira në një ngërç.

Në ligj bëhet edhe një saktësim tjetër, që, gjithashtu është një lehtësim, çmimi i qirasë së tokës nuk ndryshon edhe kur në një pjesë të vogël të saj, saç e përcakton plani i përgjithshëm vendor, ka zhvillime ndërtimore në funksion të bujqësisë apo agroturizmit.

Në qoftë se më lejohet, dua të them edhe 2-3 fjali për ligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë” i propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, por që ka lidhje të drejtpërdrejtë me misionin dhe me punën e ministrisë që unë kam nderin të drejtoj. Ky ligj, nëpërmjet këtij akti, do të bëjë lehtësimin e regjistrimit jo vetëm në Shqipëri, por edhe në të gjitha vendet anëtare të marrëveshjes së Lisbonës të produkteve tipike tradicionale, me qëllim që ato të njihen ndërkombëtarisht. Këto produkte nuk kanë qenë pjesë e fjalorit të politikës qendrore apo lokale. Gjithsesi, besoj se ato do të jenë çelësi i artë, së bashku me agroturizmin, për të kapërcyer një hendek shumë të madh, që e ndan fshatin nga mirëqenia. Ky hendek ka brenda të gjitha argumentet që ngriti zoti Sinaj, që i kemi thënë edhe më parë, të cilat lidhen me pronësinë e tokës dhe me faktin se ferma bujqësore është shumë e vogël, e copëzuar dhe e fragmentarizuar. Natyrisht, ne flasim për kooperimin, që në teori është një zgjidhje, por është një zgjidhje që do të konsumojë kohën e saj. Nuk është kaq kollaj ta shtrijmë kooperimin si formulë në të gjithë Shqipërinë. Atëherë pyetja është: cila është zgjidhja për të krijuar mirëqenie në fshat për 90% të fermerëve, të cilët shpesh i quajmë kot fermerë, sepse janë kopshtarë dhe kanë një fermë aq të vogël, saqë nuk mund të predikojmë se nëpërmjet saj mund të ndërtojnë një jetë të mirëqenë në fshat? Atëherë, çfarë duhet të bëjmë?! Duhet të diversifikojmë ekonominë e fshatit, të zhvillojmë ekonomi të tjera dhe njëra prej tyre lidhet me prodhimet

tipike tradicionale, të cilët i quajmë ndryshe tregues të origjinës, të cilët, nëse regjistrohen, marketohen siç duhet. Ne paguajmë deri në 70% të kostove të marketimit falas përmes programit tonë të mbështetjes financiare, ngremë punishtet, që i quajmë inkubatorë të prodhimeve tradicionale, për të cilat japim deri në 150 milionë lekë grant nga skema jonë kombëtare përmes AZHBR-së. Pra, t'u japim mundësi fermerëve që prodhimet e tyre tipike t'i shesin me një çmim disa herë më të lartë se sa çmimi që i shesin sot, në kushtet e mungesës së njohjes së vlerave të tyre dhe të një marketingu mizerabël dhe kjo jo për fajin e atyre, por për faj të varfërisë.

Gjithashtu, dua t'ju kërkoj, ndonëse nuk është propozuar nga ju si ministri (si pjesë e kabinetit jam i interesuar drejtpërsëdrejti për këtë ligj) jo vetëm mbështetjen për këtë ligj që do të miratohet, por ju kërkoj që të bëhemi aleatë dhe ambasadorë për ta çuar mesazhin e kësaj filozofie, pra të diversifikimit të ekonomisë, për të krijuar mundësi për të ardhura të tjera nga fshati përmes agroturizmit, prodhimeve tipike, në secilën prej zonave tona.

Realisht, dua ta falënderoj zotin Sinaj, pavarësisht notave kritike, sepse këtu nuk jemi vetëm për të duartrokitur. Ajo që tha zoti Sinaj është e vërtetë, pra duhet ta bëjmë ndonjëherë vetë oponencën apo opozitën dhe të gjitha ato që tha ai qëndrojnë.

Kam dy fjalë edhe për drejtoritë e bujqësisë. Jemi në një proces të thellë ristrukturimi, me një qasje inovative. Drejtoritë e bujqësisë janë duke u shpërbërë dhe po krijojmë dy agjenci shërbimi të mirëfillta: Agjencinë e Shërbimit Veterinar Shtetëror dhe të Mbrojtjes së Bimëve, si dhe Agjencinë e Shërbimeve të Ekstensionit për fermerët. Po i krijojmë këto agjenci, sepse nuk duam t'i ngarkojmë drejtoritë e bujqësisë, me aq pak kapacitet sa kanë, me njëmijë detyra dhe në fund fare nuk bëjmë pothuajse asgjë, se nuk dua ta shumëzoj me zero punën e tyre. Natyrisht, mundohen, por i kemi futur në një çoroditje institucionale dhe në një handicap apo dobësi të furnizimit me kapacitete, saqë edhe ata nuk kanë çfarë të bëjnë. Nuk është zgjidhja vetëm me formulë strukturore dhe organizative, pa dyshim që kemi nevojë për kapacitete.

Edhe një herë ngre alarmin se të rinjtë nuk shkojnë ende me ritmin që ne duam në degët: veterinari, agronomi, agroushqim e të tjerë. Ky nuk është vetëm një problem i Shqipërisë, por edhe i vendeve të zhvilluara. Këtu te ne, ku mezi po shkëputemi nga kultura e gjoja liberalizimit të universiteteve, që farkëtoi në mendjen dhe në moralin e gjithë të rinjve idenë se të jesh i suksesshëm nuk është e nevojshme të investosh shumë për veten, rëndësi ka të investosh te një tesserë partie apo të marrësh një diplomë çfarëdo qoftë, gjë që i ka mbushur auditorët e agronomisë, të veterinarisë dhe të degëve të lidhura me bujqësinë me studentë që shkojnë atje vetëm sa për të marrë një diplomë dhe më pas bëjnë një punë tjetër, që nuk ka lidhje me bujqësinë. Kjo është e vërteta, sado e hidhur që mund të jetë.

Ndaj, zoti Sinaj, në bashkëpunim me universitetin kemi ndërtuar një program për trajnimin e ekstensionistëve në mënyrë intensive, në mënyrë që t'i pajisim me një certifikatë dhe më pas t'i lejojmë të punojnë qoftë në tregun publik, qoftë në tregun privat si ekstensionistë të certifikuar. Një që ka mbaruar agronomi nuk është mjaftueshëm ekstensionist. Pra, problemi është pak më i thellë, ne po punojmë në atë drejtim.

Dua t'ju bëj të njohur edhe një projekt të përbashkët me Radiotelevizionin Shqiptar për të ndërtuar ekstension 24 orë në televizion. Radiotelevizioni Shqiptar shumë shpejt, shpresoj vitin që vjen, do të ketë një kanal të posaçëm, krahas kanaleve të tjera, që do të jetë kanali "RTSH Agro", në qoftë se do t'i mбетet ky emër. Ky kanal do të ketë 24 orë vetëm shërbime këshillimi për fermerët. Për shkak të teknologjisë dixhitale apo edhe të *smartphon*-ëve në fshat (ndonëse duket sikur nuk janë shumë të familjarizuar, por kur vjen fjala te nevojat, *smartphon*-i edhe në fshat do të kthehet në një mjet pune), fermeri ka mundësi që në çdo orë të ditës t'i kthehet pas mësimi apo këshillimit përmes televizionit në platformën dixhitale të RTSH-së. Edhe kjo nuk është gjithçka, sepse nuk e zëvendëson punën pranë çdo ferme, por gjithçka është proces. Ky është një proces i gjatë dhe i vështirë, por ju siguroj se ne kemi ndërtuar një grafik dhe një planpune me kalendar se si do të shkojmë drejt shërbimeve cilësore, që kanë munguar deri më sot, për fermerët.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Peleshi!

Fjalën e ka deputetja Klotilda Bushka.

Më pas fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministria, zonja Senida Mesi.
Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Edhe pse mendoj se ne në këtë vend humbim shumë kohë dhe energji duke u marrë me sqarime të spekulimeve deri te më absurdet, që serviren çdo ditë nga opozita e vendit tonë, sot vë re me kënaqësi se kohën në shërbim të njerëzve të zakonshëm të këtij vendi nuk e kemi humbur. Prandaj dua të përgëzoj qeverinë për këtë nismë, e cila nxit zhvillimin e agroturizmit dhe veprimtarive ekonomike në bujqësi dhe në blegtori. Ne kemi potenciale zhvillimi të jashtëzakonshme në këtë sektor, të cilat nxisin që njerëzit e zakonshëm të rrisin ekonominë e tyre familjare dhe të kontribuojnë në këtë drejtim, që ekonomia e vendit tonë të ketë rritje.

Mjafton të shikojmë vetëm një statistikë: vetëm vitin fundit të ardhurat nga eksportet bujqësore në vendin tonë janë rritur mbi 70%. Sigurisht, kjo ka ardhur nga e gjithë vëmendja e kësaj maxhorance të bujqësisë, të blegtorisë dhe tek agroturizmi. Jo vetëm politikat tona fiskale; të cilat e ulën tatimfitimin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor apo për strukturat e agroturizmit nga 15% në 5%; jo vetëm reforma administrative territoriale, e cila u fokusua në bujqësi dhe në blegtori, pra në menaxhimin e këtij sektori, nga ai që është pushteti më pranë qytetarit, që është pushteti lokal; jo vetëm politikat lehtësuese të TVSH-së për makineritë bujqësore; jo vetëm shtrimi i rrugëve rurale, të cilat kanë ndihmuar me infrastrukturë të gjitha aktivitetet në fshat, por edhe grantet, mbështetja direkte që u jepet sot fermerëve shqiptarë, edhe azhurnimi i tokës bujqësore dhe projekti i rilindjes rurale me “100 fshatra”, që do t’i shtohen projektit të “Rilindjes urbane”, tregojnë vëmendjen e rritur dhe prioritetin që ka kjo maxhorancë për fshatin, për fermerët dhe për veprimtarinë ekonomike në bujqësi dhe në blegtori. Sigurisht, kjo nuk vjen vetvetiu, kërkon punë. Nga ana tjetër, jo vetëm Shqipëria, por e gjithë bota e ka të nevojshme drejtimin drejt ushqimit të shëndetshëm, klimës së pastër dhe

turizmit alternativ. Ne i kemi këto potenciale dhe duhet t’i shfrytëzojmë dhe shteti duhet të lehtësojë procedurat që njerëzit t’i shfrytëzojnë këto potenciale. Jemi ende një vend që të huajt na etiketojnë si vend me ushqim bio, me natyrë bio, prandaj duhet të bëhemi tërheqës, të ofrojmë infrastrukturë dhe shërbime cilësore, të ndërthurura me traditat tona më të mira, për ta kthyer sektorin e agroturizmit, bujqësisë dhe blegtorisë në një motor për zhvillimin ekonomik të vendit. Prandaj sot përshëndes nismën e qeverisë për lejimin e ndërtimeve në pronat bujqësore, në funksion të veprimtarive të agroturizmit, të bujqësisë dhe të blegtorisë, të cilat jo vetëm do të rrisin ekonominë bujqësore familjare, por do të ndikojnë edhe në rritjen e të ardhurave të vendit tonë.

Familjet në fshat, pavarësisht traditave, pavarësisht mundësive që kanë, nuk i kanë dot jo vetëm mundësitë ekonomike, por edhe njohuritë përkatëse për të reklamuar produktet e tyre, prandaj kanë nevojë për ndihmë në këtë drejtim. Sot fermerët mund të përfitojnë nga projekti i granteve të bujqësisë, por, me keqardhje, shoh se potencialet për mbështetjen e fermerëve me grante shteti janë ende të pashfrytëzuara në maksimum, pasi fermerët nuk i kanë kapacitetet për t’i fituar këto grante.

Çështja e dytë ka të bëjë me mosregjistrimin e titullit të pronësisë për tokën bujqësore. Edhe pse është bërë një punë e jashtëzakonshme nga qeveria për azhurnimin e tokës bujqësore, sot fermerët kanë ende toka bujqësore të paregjistruara në ZRPP-të. Ndaj, shfrytëzoj rastin këtu për t’u bërë thirrje të gjitha familjeve në fshat: deri në dhjetor të këtij viti duhet të paraqiten në të gjitha bashkitë ku ato jetojnë për të kërkuar regjistrimin e titujve të pronësisë, dokumente të cilat bëhen falas nga organet e pushtetit lokal dhe nuk kanë asnjë kosto.

Pas kësaj date çdo gjë do të bëhet nëpërmjet procedurave gjyqësore, çka nënkupton më shumë kohë, para dhe më shumë energji të humbura. Prandaj të gjithë fermerët të mos e humbasin këtë mundësi që po u jep shteti, pasi, nëse e kanë tokën të regjistruar, do të kenë mundësi edhe të përfitojnë nga grantet tona në bujqësi.

Pushteti lokal duhet patjetër të ketë ide inovatore. Rilindja rurale me “100 fshatra” është

një projekt i cili duhet replikuar nga bashkitë tona për ato fshatra të cilët nuk janë në listën e parë të këtij projekti. Pra, do të jetë pushteti lokal, mendoj unë, që do të duhet të reklamojë produktet e fshatit. Kemi parë “Festën e mjalitit” në Librazhd dje, e cila tashmë është një festë traditë që po organizohet në këtë bashki. Kemi tre vjet që shohim panairët e fshatrave në të gjithë fshatrat e Tiranës. Produktet e zonave, që më parë nuk prekeshin dhe nuk bliheshin nga qytetarët e Tiranës, janë bërë tashmë shumë të afërta. Pse? Sepse janë rregulluar rrugët nëpër fshatra, janë promovuar produktet bujqësore, janë ndihmuar fermerët dhe sot jemi më të vetëdijshëm se promovimi i produkteve bujqësore ka rritur ekonominë e fshatrave.

Nga ana tjetër, privatët, biznesi i madh duhet të kenë interes që të investojnë në sektorin tonë të agroturizmit dhe të bujqësisë, sepse investimet e mëdha, apo ato që ne i quajmë “investimet e shoqërive dhe bashkëpunimit bujqësor – agroturizëm” janë sektorë kryesorë që nxisin rritjen e punësimit.

Shteti ka për detyrë të çojë infrastrukturë; ka për detyrë të bëjë politika fiskale, që t’i lehtësojë këto lloj shërbimesh, por, nga ana tjetër, do të duhet që të gjithë ata që i kanë këto potenciale t’i vënë në punë dhe t’i zhvillojnë.

Duke lehtësuar procedurat që prona publike – tokë bujqësore të përdoret për ndërtime, siç bën projektligji që na ka ardhur sot për shqyrtim, ne kemi ndihmuar të gjitha investimet në këtë sektor. Prandaj unë ju bëj thirrje të gjithëve që ta votoni këtë projektligji.

Në përfundim dua t’u them kolegëve të mi të opozitës, të cilët nuk i shoh në sallë dhe sot, në fakt, nuk kanë lënë as adresë se ku do të jenë, nuk e di se ku janë sot, nuk e di nëse kanë ndonjë mbledhje, se fshatin dhe fermerin e braktisën dhe nuk e di se çfarë u thonë atyre në mbledhjet që bëjnë. U thonë: si nuk i dëmshpërblyen ata që u përmbytën nga shirat?! U thonë se me fondet e bujqësisë abuzuan në përfitim të interesave klienteliste?! U thonë se banorët e fshatit i varfëruan më shumë se sa ishin?! Megjithatë, është e kotë që ne të merremi me opozitën, sepse opozita është në një rrugë pa krye, ndërkohë që vëmendja jonë, vëmendja e kësaj maxhorance është te njerëzit, sepse ne nuk kemi kohë për të humbur me humbësit më të mëdhenj të Shqipërisë sonë të dashur.

Edhe propozimi për vetingun në politikë, që opozita e ka hedhur si një reklamë boshe, si një pemë pa kokrra, nuk i sjell fryte fshatit dhe as qytetit. Ta kishin me gjithë mend këtë propozim, nuk do t’ia vinin ndesh këtë nismë SPAK-ut dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, sepse do të jenë pikërisht SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, ata që i vodhën fshatit gjithçka do t’i vendosë para përgjegjësisë penale dhe do t’i çojë atje ku e kanë vendin.

Ju falënderoj, të nderuar kolegë, dhe e nxis Ministrinë e Bujqësisë për nisma të tilla edhe në vijim!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka zëvendëskryeministrja. Të përgatitet deputetja Elisa Spiropali.

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që, para se të kaloj te përfitimet që vijnë nga ndryshimet e propozuara në ligjin nr. 8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore dhe pyjore”, të konkretizoj pak hapat e deritanishëm që ka ndërmarrë qeveria shqiptare në lidhje me rritjen dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë, si një nga elementet më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit, zhvillimin ekonomik të zonave rurale dhe jo vetëm.

Faktikisht ajo çfarë ne po bëjmë fokusohet në tri shtylla kryesore.

Së pari, kemi punuar dhe vazhdojmë të punojmë për paketën fiskale, duke krijuar lehtësitë dhe incentivat e bizneseve ekzistuese, por edhe atyre të reja, për të investuar dhe hapur sa më shumë biznese, për shembull, duke reduktuar TVSH-në apo duke ulur përqindjen e tatimitimit.

Kolona tjetër ku po punojmë është nxitja në formë direkte e investimeve nëpërmjet granteve, nëpërmjet buxhetit të shtetit, granteve të Bashkimit Europian apo krijimit të lehtësimit të aksesit për pronën, sikurse është edhe ligji që po diskutojmë sot.

Kolona e tretë, por jo më pak e rëndësishme, është sigurimi i funksionit ligjor dhe i gjykatave, funksion shumë i rëndësishëm për rritjen e sigurisë dhe garancisë së

investimeve të bëra, për një ligj të barabartë për të gjithë.

Kështu, në veçanti për bujqësinë dhe zhvillimin rural, kemi reduktuar nga 20% në 6% tatimin mbi vlerën e shtuar për të gjitha strukturat që zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm. Kemi reduktuar normën e tatimit nga 15% në 5% për të gjitha ato ekonomi, të cilat do të ofrojnë dhe nxisin edhe fermerët në lidhje me shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, duke incentivuar kështu bashkimin e ekonomive të vogla. Kemi mbyllur me sukses fazën e parë për skemat e mbështetjes kombëtare, që këtë vit u realizua në zero dokumente, duke lehtësuar kështu edhe barrën e çdo fermeri për sjelljen e dokumentacionit, si dhe nga ana e qeverisë shqiptare kemi marrë të gjitha masat e nevojshme për hapjen e programit të financimit IPARD II. Janë 71 milionë euro, të cilat do të investohen në sektorin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, dhe së bashku me 23 milionë euro, që ishte vlera e financimit nga buxheti i shtetit, do të shkojnë në mënyrë direkte në rritjen dhe zhvillimin e bujqësisë, ku përfitues direkt janë fermerët e blegtorët dhe jo vetëm.

Angazhimi për këtë sektor nga ana e qeverisë është shumë i madh dhe jo vetëm, por në këtë angazhim po punojmë ngushtësisht edhe me partnerët tanë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Kjo, në fakt, është sfida më e madhe që i është prezantuar deri tani sektorit të bujqësisë, prandaj na takon neve, si qeveri, të përfundojmë të gjithë infrastrukturën e duhur jo vetëm me procesin e rëndësishëm të integritit në Bashkimin Europian, por të bëjmë gati të gjithë strukturën edhe nga ana ligjore që fermerët dhe blegtorët tanë të përfitojnë atë çfarë duhet dhe meritojnë.

Për sa u përket kritereve të Bashkimit Europian, të gjithë e dimë se ato janë në rritje dhe, sigurisht, na takon neve të edukojmë fermerët dhe të punojmë me ta, me qëllim që ata të përfitojnë dhe të thithin sa më shumë nga këto investime. Në këtë kontekst, për të nxitur edhe investorët vendas që t'i përthithin këto fonde, janë propozuar edhe ndryshimet aktuale ligjore, të cilat lejojnë ndërtimin në toka bujqësore, të dhëna me qira, të objekteve që do të përdoren për të ndërtuar objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale apo objekte në funksion të agroturizmit.

Ndërkohë që aksesimi për financim ekziston dhe nuk ka, le të themi, probleme të theksuara. Aftësia për të përthithur sa më shumë nga këto fonde, sidomos në skemat e Bashkimit Europian dhe programit IPARD, mbetet një sfidë, të cilën ne duhet ta adresojmë. Universitetet, shoqëria civile apo edhe biznesi kanë mundësi t'i përthithin këto fonde dhe të punojnë së bashku me fermerët dhe blegtorët, me qëllim përthithjen sa më të madhe të këtyre fondeve.

Zhvillimi rural nuk ngelet vetëm në zhvillimin rural dhe fshatrat në konceptin e atyre "100 fshatrave", edhe ky program tejet ambicioz. Ju siguroj se një zhvillim i tillë i zonave rurale ka efektin e tij zinxhir edhe në rritje të elementeve të tjera të tregtisë apo të eksportit në lidhje me të gjithë ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit tonë.

Në fakt, ne duam të krijojmë një bujqësi moderne, me zhvillim të qëndrueshëm, e orientuar ndaj tregut dhe shtetit, pasi vetëm një bujqësi, e cila ia del të përmbushë, nga njëra anë, nevojat e tregut dhe, nga ana tjetër, të prodhojë edhe për eksport, është në gjendje që të krijojë të ardhura të qëndrueshme për fermerin dhe për ekonominë kombëtare.

Ta realizosh këtë do të thotë që të jesh në gjendje të eksportosh në Bashkimin Europian dhe kjo nuk është e lehtë, por as e pamundur, sepse çdo ditë ne kemi raste suksesi të cilat po i promovojmë, dhe po ia dalin të eksportojnë në vendet më të avancuara të Bashkimit Europian. Por, sigurisht, kjo kërkon ngritjen e kapaciteteve teknike dhe njerëzore qoftë të fermerëve, qoftë edhe të administratës sonë publike, me qëllim që t'i ndihmojmë të gjithë fermerët dhe blegtorët për të qenë të gatshëm për këtë eksportim.

Ne duhet të jemi konkurrues edhe me volumen, në fakt, dhe këtu kam një thirrje për të gjithë fermerët.

Të nderuar fermerë, ju duhet t'i njihni të gjitha benefitet që vijnë nga partneriteti korrekt dhe i kujdesshëm në biznes. Fermat e vogla nuk janë më të konkurrueshme. Për këtë arsye, e gjithë paketa fiskale dhe incentivat shkojnë drejt të gjitha formave të ndryshme të bashkimit, me qëllim që të përfitohet nga ekonomia e shkallës, në mënyrë që ju të përthithni sa më shumë fonde dhe investime.

Qeveria jonë e ka vëmendjen ndaj çdo qytetari dhe synon rritjen e sigurisë dhe

mirëqenies së të gjitha shtresave dhe shoqërisë sonë. Nuk ka investime të sigurta, me impakt në mirëqenie nëse investitori nuk është i sigurt, ndaj, edhe në kuadër të vendosmërisë, po punojmë në disa reforma shumë të rëndësishme. Çdo investitor dëshiron që investimi i tij të jetë i sigurt, që ligji të mbizotërojë mbi çdo gjë, që ligji të jetë i barabartë dhe të jetë mbi palët. Sipërmarrësi është i gatshëm të pranojë riskun e falimentimit nëse plani i tij i biznesit nuk del i suksesshëm, por kurrësi nuk do ta pranojë fatin që të trajtohet ndryshe pranë sistemit tonë të drejtësisë. Prandaj dua të vlerësoj dy elemente shumë të rëndësishme.

Së pari, operacionin “Forca e ligjit”, i cili është duke vepruar prej kohësh dhe ka dhënë rezultate konkrete, ku janë goditur disa grupe kriminale, por hetimet vazhdojnë dhe të tjerë do të goditen. Lufta kundër krimit të organizuar nuk lejon asnjë kompromis, sado risk që mbart, dhe ne jemi të sigurt dhe të vendosur për t’i siguruar dhe garantuar jetën dhe mirëqenien çdo individit, qytetari apo investitori, qoftë ky vendas apo i huaj.

Më lejoni të përgëzoj të gjitha strukturat e policisë dhe të prokurorisë për aksionin e para dy ditëve në Shkodër, ku, pas një pune më shumë se gjashtëmujore, u godit njëra prej bandave më kriminale që operonte në qytetin tim të lindjes, në Shkodër, prej më shumë se njëzet vjetësh.

Reforma në drejtësi, një element tjetër shumë i rëndësishëm, nëpërmjet vetingut, që po e shohim se po jep rezultate dhe ngritjes së organeve të reja, do të mundësojë më në fund drejtësinë e re, e cila është një parakusht për çdo hap që ne hedhim drejt zhvillimit ekonomik, rural apo çfarëdolloj tjetër elementi, i cili i siguron Shqipërisë një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Opozita, në fakt, kërkon të bëjmë veting edhe në politikë. Por le t’i mbarojmë të gjitha reformat që kemi nisur dhe, patjetër, t’ia hapim rrugën edhe vetingut në politikë, duke filluar me ne, që jemi prezentë këtu, të majtë e të djathtë apo në qendër. Asnjë reformë nuk qëndron e shpëputur nga tjetra. Për ne të gjitha reformat i bashkon pikërisht angazhimi si qeverisje për të përmirësuar jetën e çdo shqiptari, për të siguruar një të ardhme më të mirë këtu, në vendin tonë, me një vëmendje maksimale ndaj çdo qytetari të zakonshëm të këtij vendi.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Mesi!

Fjalën e ka deputetja Spiropali. Të përgatitet deputeti Taulant Balla.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Elisa Spiropali – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Nëse në Teatrin e ri Kombëtar, që do të ngrihet në Tiranë, opozita do të vinte në skenë një pjesë teatrale, pa diskutim, që do të ishte Makbethi, jo për shkak të ngjashmërisë së supozuar apo të vërtetuar të liderit shpirtëror të opozitës me personazhin në fjalë, as edhe për intrigat e oborrit të kryetarit holandez, jo skocez në këtë rast, sesa për faktin që drejtuesit e opozitës së bashkuar, që piqen nëpër salla hotelesh, ngjajnë si pika uji me korin e magjistricave të tragjedisë së madhe.

Besoj i mbani mend edhe ju, të dashur qytetarë, ja, për kujtesë: “Kokë gjarpri laragan; ziej, piqu në kazan; sy kuçedre, bisht bretkose; gjuhë qeni, qime dose; cfurk nëpërke, thumb prej grere; panç’ agrepi, gjemb prej ferre; për magji e gjëmë ferri, ziheni si çorbë derri”.

Gjuha e helmatisur e opozitës zbardh të zezën dhe nxin të bardhën, pa asnjë përkujdesje për qytetarët. I helmojnë përditë me gjuhën e urrejtjes pa anë dhe pa udhë: “kriminele”; “vrasës”; “hajdutë”; “trafikantë”; “do t’ju mbysim”; “do të rrëzoheni”; “na prisi”; “erdhëm” e të tjera, e të tjera, gjuhë primitive që shkatërron besimin te politika, së pari, çorbë e gatuar për të helmatisur mëngjeset, drekat dhe darkat e nënave, që çojnë fëmijët në shkollë, gjyshërve dhe gjysheve, që duan një pension më të mirë, fermerëve që duan të kalojnë ligje si ky i sotmi për të pasur një mundësi më shumë për veten, të rinjve që kanë uri për shpresë në këtë vend, të urtëve që duan të dëgjojnë ide, atyre që e duan vendin, këta duan t’u bërtasin në fytyrë: “Ikni, se Shqipëria nuk bëhet!”, një politikë antikombëtare kjo, e cila synon t’i llangosë të gjithë, me shpresën se do të shkatërrojë terrenin, ku mund të ndërtohet diçka. Një kronikë e zezë, e përzier me *fake news*, me deformime të së vërtetës nga fillimi deri në fund.

Si mundet që një strategji opozitare të jetë e ndërtuar e tëra mbi deformimin, mbi shpifjet dhe mbi fyerjet?

Po marr vetëm 2 shembuj kuptimplotë të kësaj jave, fyerjet e papërballueshme për prokurorinë, për Prokuroren e Përgjithshme të përkohshme dhe për Policinë e Shtetit.

E para u ka prishur të gjitha hesapet dhe po ua shkul me themel follenë, që e kishin ngritur vetë në prokurorinë e shtetit. Po u lëviz prokurorët, të cilët nuk lëvizën kurrë një dosje nga vendi.

Ashtu siç bëjnë përgjithësisht burracakët, ata që nuk kanë forcë kur një grua është e fortë, fillojnë ta sulmojnë për moral, për nder, e fyejnë dhe mundohen ta llangosin, ashtu siç po bëjnë me Prokuroren e Përgjithshme të përkohshme, e cila po shfaqet si një grua e fortë në krye të atij institucioni dhe po ia del që së bashku me Policinë e Shtetit, të godasë disa nga grupet kriminale, që kanë operuar për 20 e kusur vjet në vend, pa u hyrë asnjë gjemb në këmbë.

Ata kishin shpresuar se do ta fundosnin reformën në drejtësi. Ja ku po del rezultati, reforma në drejtësi po i fundos ata, që kishin marrë peng prokurorinë dhe gjykatat. Ajo po bën punën, po pastron sistemin dhe po ngre një katedrale të re në gjyqësor.

A është e vështirë? Patjetër, është e vështirë, por ata duhet të vijnë këtu dhe të bëjnë detyrën për të cilën janë votuar, në mënyrë që të gjitha institucionet e sistemit të ri të drejtësisë të shkojnë tani në vend (KLP-ja, KLGJ-ja, ONM-ja dhe Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion). Të mos shpikin hilerë me vetvetingje për t'i ikur së pashmangshmes, ndërtimit të strukturave të reja të drejtësisë!

E dyta, nuk po lënë gjë pa thënë për Policinë e Shtetit. Jo këtu, se këtu nuk vijnë fare, por nëpër salla të tjera. Sot ata janë te hotel "Tirana". Nuk e di në cilin kat janë, por di që ata janë duke punuar për vete, jo për njerëzit. Ata nuk vijnë këtu të flasin për bujqësinë apo për arsimin, nuk vijnë këtu të diskutojnë për drejtësinë dhe të ngrenë çështje, kur vjen dhe raporton kryeprokurorja. Nëse kanë probleme me punën e kryeprokurores apo me Prokurorinë e Përgjithshme, duhet të vijnë këtu dhe të përballen me të, por ata nuk e bëjnë këtë. Ata e shmangin përballjen, sepse e vetmja gjë që duan të bëjnë është nxirja e realitetit.

Për Policinë e Shtetit nuk thanë asnjë fjalë të mirë, këta, "heronjtë e dekriminalizimit të vendit", këta, që nuk kanë lënë asnjë politikan,

asnjë deputet dhe asnjë ministër pa e shpallur kriminel.

Në momentin që një bandë e vërtetë me kriminele të vërtetë, e cila ka punuar në Shkodër për 20 vjet, kapet, me punën e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me policinë holandeze, ata heshtin. Kanë gjetur kriminelë të tjerë.

Kemi një opozitë, e cila merret me kronikën e zezë: Kush u vra? A u kap? A u vra? Kur do të kapet? Pse, ky është vizioni i opozitës shqiptare? Kështu do t'i bindin njerëzit, që këta janë një forcë e denjë për të qeverisur?

Njerëzit kanë nevojë për shpresë, ndërsa këta duan t'ua thajnë shpresën në këtë vend, prandaj është shumë e rëndësishme që ne t'u shkojmë deri në fund reformave tona. Vetingu dhe institucionet do të bëhen dhe pandëshkueshmëria e politikës do të marrë fund. Të ndahet njëherë e mirë se kush është shpifësi, kush është ai për të cilin shpifet, kush është kriminel i hajduti dhe kush është politikani, deputeti, që njerëzit të kenë besim te publikja dhe te ky profesion, të besojnë se mund të ndërtojmë diçka për të ardhmen.

Për Policinë e Shtetit, për ministrin e Brendshëm kanë lëshuar të gjithë batarenë dhe nuk është rastësi që Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme janë institucionet më të sulmuara. Jemi në fund të një beteje, që e nisi me shumë guxim PS-ja dhe qeveria shqiptare, një reformë për të cilën askush nuk vinte bast dhe nuk e besonte, dhe ja ku jemi. Më në fund do të kemi një sistem drejtësie dhe një politikë të ndarë nga njëra-tjetra. Kjo ka shkaktuar goditjen e krimit deri në themelin e vet, aty ku janë lidhjet e politikës me krimin. Kjo ka shkaktuar këtë çoroditje të përgjithshme.

Ne urojmë sinqerisht që të vijojë puna në Kuvend duke diskutuar ligjet e këtij vendi dhe politikat. T'i japim fund njëherë e mirë politikës, që i ka larguar njerëzit nga televizionet dhe nga gazetatat, që fatkeqësisht, i bëjnë shpesh jehonë kësaj mungese atdhedashurie për vendin, duke folur pa teklif për gjithçka.

Ajo që dua të them në fund, është se ashtu si në një tragjedi nga e cila nuk ka asnjëherë dalje, të paktën në letër, uroj që opozita të mos jetë futur në një rrugë krejtësisht pa krye, e cila e nxjerr përfundimisht nga sistemi, e

margjinalizon dhe e kthen në një forcë të parëndësishme.

Uroj që shpresa e tyre të mos jetë dalja nga sistemi zgjedhor apo mosfutja në zgjedhje, sepse atëherë fati i tyre do të jetë i përcaktuar, ashtu siç është në tragjeditë e mëdha. Aty ku nuk ka rrugë, nuk ka as rrugëdalje. Të dalin nga ai shteg ku janë dhe të kthehen këtu, në rrugën e politikës!

Faleminderit të gjithëve!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Spiropali!

Kam një kujtesë për të gjithë kolegët. Në qoftë se keni çështje që lidhen me aktualitetin dhe nuk janë pjesë e rendit të ditës të miratuar, mund të diskutoni në pjesën për çështjet jashtë rendit të ditës, për të cilat kemi në dispozicion 60 minuta.

Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Andrea Marto!

Përgatitet deputeti Bujar Çela!

Andrea Marto – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sot po shqyrtojmë projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave, që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar”.”.

Ligji nr. 8318, datë 1.4.1998, përcakton dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave në pronësi shtetërore subjekteve fizike dhe juridike, shtetas të vendit apo të huaj tokën. Kushtet e dhënies me qira të tokës rregullohen ndërmjet palëve kontraktuese me një kontratë të veçantë, në përputhje me kërkesat e Kodit Civil, të akteve ligjore dhe nënligjore për tokën bujqësore, livadhet, pyjet, kullotat, ujërat, peshkimin dhe mjedisin. Dhënia me qira e tokës pasuri shtetërore nga organet përkatëse bëhet nëpërmjet ankandit. Aktet e dhënies me qira për tokën bujqësore pasuri shtetërore janë:

-Deri në 10 vjet për kontratat e qirasë afatshkurtër, ku përfshihet veprimtaria për prodhimin e bimëve të arave dhe atyre eterovajore.

- Deri në 30 vjet për kontratat e qirasë afatmesme, ku përfshihet veprimtaria për prodhimin blegtoral, për prodhimin e fidanëve, mjediset e mbrojtura dhe pyjet e ulëta.

- Deri në 99 vjet për kontratat e qirasë afatgjatë, ku përfshihet veprimtaria për turizëm, rekreacion, pyjet e larta dhe pemët frutore.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i kushteve të ndërtimit të objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, si dhe objekteve në funksion të agroturizmit në tokat bujqësore, që janë pasuri shtetërore, me destinacion dhënien me qira të tyre, me qëllim rritjen e investimeve dhe të efektivitetit të përdorimit të tyre dhe rritjen e punësimit.

Duke qenë se gjatë procesit të qiradhënies, ndonëse qiramarrësit kërkojnë të realizojnë të gjithë ciklin (prodhimin, ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe përpunimin e tyre), të marrë nga sipërfaqja e tokës bujqësore, objekt i qiradhënies, lejimi i ndërtimit të objekteve të tilla dhe kushtet sipas të cilave kryhen ato, nuk është i përcaktuar në dispozitat e ligjit në fuqi. Është parë e nevojshme të ndërhyhet në ligjin ekzistues, duke bërë të mundur realizimin e ndërtimeve përkatëse dhe kushtet specifike të nevojshme, të cilat rregullojnë marrëdhënien e qiradhënësit me qiramarrësit.

Një nen i ri është vënë për rastet kur për tokat bujqësore objekt i qiradhënies kërkohet nga qiramarrësi të ndërhyhet për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe përpunimin e tyre apo objekte në funksion të agroturizmit, për të cilat kërkohet leje ndërtimi dhe kategoria e resursit nga tokë bujqësore, ndryshon në truall ndërtimi. Këto ndryshime do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit, me dokumentet përkatëse, planin e përgjithshëm vendor të bashkisë në territorin e së cilës ndodhet toka bujqësore që jepet me qira.

Gjithashtu, për objektet e ndërtuara sipas këtij ligji nuk lejohet në asnjë rast të ndryshohet destinacioni i funksionimit të tij, pasi ato realizohen në shërbim të qëllimit të qiramarrjes. Këtu duhet të shtoj se për vite me radhë nga ish-komunat dhe ish-bashkitë janë dhënë shumë toka me qira (me mijëra hektarë), të cilat kanë pasur kontrata afatgjata deri në 99 vjet. Një pjesë e mirë e këtyre tokave të dhëna me qira, nuk i kanë respektuar kushtet e kontratës, bile në ato që kanë pasur kontrata për dru frutorë mund

të gjenden sot edhe ndërtime që nuk i shërbejnë as objektit të këtij ligji.

Pas ndërprerjes apo përfundimit të afatit të qiradhënies objekti ndërtimor kalon në pronësi të qiradhënësit pa shpërblim.

Një tjetër ndryshim në këtë ligj është: kur mbi sipërfaqen e tokës, objekt i qiradhënies parashikohet kryerja e një investimi publik, atëherë kompensimi i qiramarrësit për shpenzimet e kryera bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shpronësimet për interes publik.

Gjithashtu, shfuqizohet dispozita, ku parashikohet se qiradhënësi është i detyruar ta kompensojë qiramarrësin për shpenzimet e kryera, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil dhe të tipit të investimit.

Si përfundim, nën administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjenden sot rreth 20 mijë hektarë tokë, e cila mund të jepet me qira. Nga kjo, vetëm 3500 hektarë janë dhënë me qira. Pra, mbetet një sipërfaqe e konsiderueshme dhe me ndryshimet që sjell ky ligj, kjo mund të joshë investitorët dhe mund të kemi mjaft ndryshim në shumë zona të vendit, ku do të zhvillohet prodhimi bujqësor, produkte të gatshme bujqësore dhe do të rritet punësimi.

Për këtë arsye, ju ftoj, të nderuar kolegë, ta votojmë projektligjin në fjalë!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Marto!

Fjalën e ka deputeti Bujar Çela!

Përgatitet deputetja Milva Ekonomi!

Bujar Çela - E nderuar drejtuese e seancës, Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë, që jeni të interesuar për ndryshimet e këtij ligji,

Ky ligj nuk është një ligj i ri. Ai ndryshon vetëm disa nene, që bëhen më praktike dhe më të lehta për t'u shërbyer dhe për të marrë përgjegjësi në lidhje me marrjen e tokës me qira.

Përhëndes edhe këto karrige bosh, të cilat shkëlqejnë më shumë se kurrë me mungesën e atyre, që i posedojnë padrejtësisht!

Shpjegimin e ndryshimeve në ligj e dha shumë qartë zoti Marto gjatë fjalës së tij për çdo tokë të marrë me qira. Ndryshimet ofrohen për të gjitha pronat që janë pronë shtetërore (toka bujqësore e pyjore, të livadhe dhe kullota).

Unë do të ndalem te mënyra se si është vepruar deri në këto momente për marrjen e

tokës me qira. Ka jo pak raste, kur qytetarë të ndryshëm, duke u nisur nga parimi: "T'u qepemi kodrave dhe maleve dhe t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat", kanë hasur një fenomen: qytetarët e interesuar, ata të cilëve u takon toka, sepse e punojnë atë, e kanë kryer këtë detyrim, por për çudi këto toka kanë dalë në ankand dhe u janë dhënë me qira njerëzve, të cilët nuk dinë ku është toka, as nuk e punojnë këtë tokë, janë njerëz të artit, medias, humorit, por pozicionin ku ndodhet toka nuk e dinë. Rastet konkrete i kemi në zonën e Lushnjës.

Në lidhje me diskutimin e kolegut Sina, i cili thotë se po mbarojnë certifikatat e ndara nga ATP-të, unë mendoj se do të jemi të detyruar së shpejti ta rishtyjmë afatin për to.

Bashkitë nuk kanë bërë asgjë, thjesht kanë marrë porosi nga parlamenti, nga qeveria, kanë shtuar administratën, por asnjë certifikatë nuk është bërë gati që vendimet, të cilat janë përpunuar në kadastrën e bashkive, të kalojnë në këshill bashkiak dhe të shkojnë drejt hipotekave.

Unë e kam bërë si propozim dhe po e përsërit se është e domosdoshme të rifillojë matja e tokës (së dhënë) më parë. Mjaft me historinë e drejtimit të fermerëve drejt zyrave të noterëve, ku certifikata mund t'iu jepet, por duhet të heqin dorë nga 80 ose 100 metra katrorë tokë që u figuron tepër. Ne e dimë fare mirë që atë tokë që është ndarë në vitin 1991 nga komisione, të cilat i falënderojmë për kohën që kanë punuar, matjet janë bërë jo në mënyrë dixhitale, por me këmbalec, me hapa, me litarë, me mjete rrethanore. Ne duhet ta mbylлим njëherë e përgjithmonë këtë proces.

Unë propozoj të rimatet saktë, jo të rindahet, pasi në Kuvend kemi miratuar që 10% e kësaj toke duhet t'i kalojë me pagesë fermerit më të afërt. Prandaj toka duhet të rimatet.

Në këtë formë ne e kemi lënë për 28 vjet dhe pushteti vendor dhe ministrinë përkatëse nuk kanë bërë punën e duhur. Përse? Kemi lënë pas dore ato vepra që ka bërë natyra, lumenjtë dhe përrenjtë. Kemi lënë pas dore kanalet vaditëse dhe kulluese, të cilat, e kam thënë dhe rithënë, po nuk ua rikthyem ndërmarrjeve të ujërave, ne nuk do të kemi as kullim, as vaditje, por nuk do të kemi as shfrytëzim të këtij kapitali të madh të burimeve hidrike, që kjo qeveri, ky popull i paguan. Realisht ato nuk shfrytëzohen. Ka pasur vepra, të tilla si rezervuarë me funksione të

trefishta, ujëmbledhës për vaditje, ujëmbledhës për të penguar përmytjen dhe për rasatet e peshkut. Një pjesë e mirë e këtyre rezervuarve janë katandisur vetëm në këtë të fundit, rasatet peshku, të cilat mbushen çdo ditë me dhe, por kapaciteti mbajtës i tyre po shkon drejt fundit. Kjo nuk është punë vetëm e Ministrisë së Bujqësisë, por mendoj se lidhet me trajtimin e tokës, ku ne të fillojmë matjen e tokave nga bankinat e lumenjve, të matim truallin e lumit, kanalit vaditës, rrugëve dhe pronës shtetërore, pastaj të matim pronën e fermerit. Metoda e rimatjes së këtyre 50 metrave, “Çfarë bën moj Nastë? Po qep thasë”, me teknikë, me topografë, të cilët heqin vija, por në fund fare nuk bëjnë asgjë ligjore, është e destinuar të dështojë. Në qoftë se ne do ta rimasim tokën me ato kapacitete që kanë bashkitë, nën drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të ndonjë ministrie tjetër, që është e interesuar për legalizimin dhe formalizimin e tokës, ne nuk do të gjejmë karar. Vetë bashkitë me kapacitetet e tyre një sahat e më parë duhet ta fillojnë dhe të përfundojnë një fshat në muaj, të mbarojnë inventarizimin e pronës duke i caktuar secilës pronë pronarin e saj, në fillim janë ato që i ka bërë vetë natyra, pastaj dora e njeriut, pastaj fermeri, ish-pronari e të tjerë.

Duke shprehur votën time pro për këto ndryshime në ligj, ju falënderoj!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Milva Ekonomi.

Milva Ekonomi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur bashkëqytetarë,

Unë besoj se të gjithë e kemi kuptuar që qeveria e sotme ka më shumë se kurdoherë tjetër bindjen që jo çdo gjë duhet ta bëjë shteti në sektorin e bujqësisë. Shteti thjesht mund të orientojë dhe të mbështesë, por ndryshimin duhet ta bëjë, në radhë të parë, iniciativa private dhe ndryshimi duhet të ndodhë brenda fshatit qoftë nga sipërmarrësit, qoftë edhe nga njerëzit që e duan fshatin, qoftë edhe nga ata që kanë ikur dhe duan të rikthehen në fshat. Ndaj vëmendja e Partisë Socialiste në gjithë këto vjet për fshatin lidhet me programet që kishin të bënin me mbështetjen e tij direkt ose indirekt.

Reforma territoriale i dha një shans fshatit për t’u zhvilluar, reforma e ujit po i jep një shans fshatit për t’u zhvilluar, shtimi i rrugëve rurale

po i jep një shans fshatit për t’u dimensionuar, gjithashtu, edhe lehtësimet që po ndodhin në procedurat eksportuese po u japin një shans fermerëve për të shtuar prodhimin e tyre. Por nuk duhet të harrojmë se jemi në prag të programit “100 fshatra”, ku janë përfshirë tashmë 4 ministri dhe një zë të veçantë ka iniciativa sipërmarrëse, e cila mbështetet nga një program i dedikuar për këtë gjë, i mbështetur edhe nga fondet e Bashkimit Europian, me një shumë prej 11 milionë eurosh, që vijnë pikërisht për këtë program.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh që kreativiteti i çdo individi dhe këmbëngulja e sipërmarrësve duhet të mbështetet në çdo cep të vendit, sepse të gjitha projektet, që mund të jenë një sukses i plotë, bëhen mirë vetëm nëse ka një organizim shumë të mirë midis atyre që e kryejnë, atyre që e mendojnë, por edhe atyre që mbështeten nga shteti.

Projektligji që ne po diskutojmë sot nuk është një projektligj i ri, ai daton në vitin 1998, për dhënien me qira të tokës bujqësore dhe pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetërore, por sot vjen me një dimension të ndryshuar, i cili ka rrjedhur nga zbatimi i këtij ligji deri tani.

Në fakt, ajo që është vënë re ka lidhje jo vetëm me prodhimin e shtuar, por edhe me nevojën që bujqësia shqiptare të shtojë zinxhirin e vlerave. Prandaj, ka shumë nevojë që atje ku prodhohet të ketë një mundësi të mirë dhe të qëndrueshme që këto produkte të përpunohen, të ruhen dhe çohen më tej. Prandaj, për të gjitha ofertat e prezantuara deri tani ka nevojë për ndryshime ligjore, të cilat bëjnë të mundur shtimin e prodhimit bujqësor.

Në fakt, ky projektligj merr në konsideratë nga ligji i mëparshëm disa gjëra: ai nuk ndryshon statusin e tokës në kuptimin e humbjes së zinxhirit të vlerave, por ajo shndërrohet nga një tokë bujqësore, në një tokë truall që i takon vetëm sektorit të bujqësisë.

Nga ana tjetër, projektet që kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve, që shtojnë zinxhirin e vlerave, nuk e ndryshojnë destinacionin në vite. Edhe pas përfundimit të këtij projekti ndërtimor ai i kthehet si pasuri pa shpërblim vetë qiradhënësit, gjithashtu, lehtësohen të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me shpronësimin për interes publik të kësaj sipërfaqje toke.

Gjithashtu, ky projektligj vjen në momentin kur ne po përpiqemi fuqimisht të forcojmë rolin që ka fermeri në prodhimin bujqësor të vendit, prandaj sot u bëhet thirrje të gjithë atyre që janë përfitues të tokës bujqësore, në fshatin ku ata jetojnë, që në zbatim të ligjit nr.7501, të plotësojnë dosjen e tyre për të marrë falas titullin e pronësisë deri në fund të vitit, pra pa asnjë kompensim financiar. Kjo është një thirrje që bëhet për të gjithë fermerët tanë, të cilët në të gjithë këto vite e kanë pasur tokën legjitime, sepse e kanë punuar ose e kanë pasur legjitime për shkak të pronësisë.

Të dyja këto ndryshime që po ndodhin në legjislacionin aktual tregojnë se vëmendja po kthehet drejt bujqësisë, stimulimit të saj dhe zinxhirit të vlerave. Këto janë iniciativa që merren për të bërë së bashku fermerin dhe sakrificën e tij, iniciativën sipërmarrëse dhe përgjegjësinë shtetërore.

Po të vëmë re të dhënat e INSTAT-it për vitet 2013 – 2017, bujqësia e ka rritur kontributin e saj në prodhimin e brendshëm bruto me 1,7%, ndërsa prodhimin e ka rritur me 10%. Sipërfaqja e mbjellë me kulturën e bimëve të arave në këta vjet është shtuar me 2,7%, ndërsa sipërfaqja e mbjellë me perime është shtuar 7%. Eksporti neto i produkteve bujqësore është rritur më shumë se 2,5 herë, ndërsa vlera monetare e realizuar nga eksporti në vitin 2017 ishte 30 miliardë lekë.

Pra, bujqësia dhe zinxhiri i vlerave akoma dhe më shumë mund të ndihmojnë për të zhvilluar zonat rurale në Shqipëri për ta vendosur në qendër fermerin, por edhe sipërmarrjen private.

Ky ndryshim që po vjen me këtë ligj pa dyshim që është një provë tjetër e vizionit socialist për të ndërtuar çdo sektor të ekonomisë në shërbim të njerëzve dhe mirëqenies. Vendosmëria jonë për të çuar përpara optimizmin dhe pozitivitetin në shoqëri mbetet një angazhim i padiskutueshëm dhe i përhershëm i maxhorancës.

Para se ta mbyll fjalën time, dua të bëj një thirrje për të gjithë ne, që duam të ndërtojmë një Shqipëri europiane dhe demokratike: duhet të mbështetim Prokuroren e Përgjithshme, e cila është duke bërë detyrën e vet me shumë dinjitet, duhet ta mbrojmë nga sulmet që po i bëhen asaj nga njerëz që nuk duhet t'i bëjnë këto sulme.

Gjithashtu, duhet të kuptojmë që detyra e Prokurores së Përgjithshme nuk mund të jetë e kryer më mirë se sot, kur edhe Policia e Shtetit po bën detyrën për të kapur bandat kriminale që veprojnë në territorin e vendit.

Të dashur kolegë deputetë, ky projektligj na tërheq vëmendjen edhe për një gjë tjetër, duhet t'i kthehemi punës më shumë se kurrë. Kjo punë bëhet jo vetëm nga sipërmarrja qytetare, por edhe nga ajo fshatare në vendin tonë.

Kështu që ju bëj thirrje për ta votuar këtë projektligj me të gjitha ndryshimet që ai ka!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Fjalën e ka deputeti Taulant Balla.

Taulant Balla- Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Së pari, sa i përket ligjit për dhënien me qira të tokës bujqësore, ai është vijim i angazhimit tonë për ta kthyer investimin në agroturizëm si një prej prioriteteve tona të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në zonat rurale.

Ky është një hap i madh për të cilin gjej rastin të falënderoj Ministrinë e Bujqësisë dhe ministrin, që sollën këtë propozim për të lehtësuar të gjitha mundësitë për të investuar në njësi agroturizmi jo vetëm në zonat që janë përzgjedhur si pjesë e “100 fshatrave”, por në të gjithë territorin.

Nuk mund të rri pa risjellë në vëmendje disa problematika që lidhen me abuzimet 27-vjeçare të dhënies së tokave me qira në Shqipëri, për të cilat, zoti Ministër, unë mendoj që ne duhet të sjellim një ligj tjetër të ri për t'i riparë të gjitha kontratat e dhënies me qira të tokave. Jo të gjitha tokat e dhëna me qira sot janë në shfrytëzim, përkundrazi kemi edhe raste, këtu unë përshëndes angazhimin tuaj personal, siç është kontrata e firmosur nga paraardhësi juaj, zoti Panariti, me familjen Balili, që ende nuk ka marrë zgjidhjen e duhur për shkak se kontrata është qepur shumë mirë, por unë mendoj se ligji duhet të jetë i fortë edhe në këtë rast. Nuk mund që, nga njëra anë, Balilajve t'u sekuestrojmë hotelin dhe, nga ana tjetër, 90 hektarë tokë, të marra me qira po nga shteti, të mos kemi mundësi t'ia sekuestrojmë. Edmond Panariti, ish-ministri i Bujqësisë i Lëvizjes Socialiste për Integrim ka firmosur atë kontratë, e cila sot nuk

mund të jetë e vlefshme, duhet të gjejmë hapësirat ligjore që atë kontratë ta bëjmë të pavlefshme, sepse nuk është në emër të të kërkuarit, por është në emër të të vëllait. Kjo pak rëndësi ka.

Kjo e bën qesharake të gjithë opozitën “turistike”, e cila edhe sot nuk gjeti mundësi të ishte në sallën e Kuvendit të Shqipërisë për të diskutuar për një çështje reale, sikurse janë problemet në fshat të tokave bujqësore, por vijon turin e radhës në hotelin turistik të radhës.

Zoti Ministër, kisha edhe diçka tjetër, për shkak se Ministria e Bujqësisë është qeverisur 4 vjetët e shkuara nga ish-aleati ynë, Lëvizja Socialiste për Integrim, por edhe për shkak se në 8 vjetët, para 2013-ës, është bërë një abuzim jo vetëm me tokat bujqësore, por edhe me liqenet. Në Belsh liqenet janë dhënë me qira për gjoja kultivim peshku dhe në qendër të Belshit peshqit ende gjoja ushqehen me glaset e pulave, sipas kontratës që na ka firmosur ish-aleati ynë në qeveri. Këto qira duhen anuluar, zoti Ministër, sepse realisht dëmtojnë zhvillimin e turizmit në zonën e Belshit. Nuk mund të vazhdohet më me kontrata të këtij lloji dhe auditetet, prokuroria duhen nxitur për t’i parë të gjitha këto kontrata njëra pas tjetrës.

Sot shqiptarët do të dëgjojnë historinë tjetër qesharake të pseudoopozitës sonë me gjoja propozime antimafia, luftë kundër oligarkëve. A mund ta besojë kush në Shqipëri që mund të bëjë luftë kundër oligarkëve gjobaxhiu i oligarkëve, Lulzim Basha?! Media ka bërë publike javën e kaluar në një emision investigativ, emisioni “Stop” në televizionin Klan, se si të gjitha kompanitë e mëdha në vend, ato me mbi 100 milionë euro lëvizje kapitali në vit, kanë kontraktuar për konsulencë kompanitë e kunatit dhe të bashkëshortes së Lulzim Bashës, konsulencë në fushën e reklamës mediatike, e nuk e di çfarë tjetër, ku njëra prej këtyre kompanive, e cila quhej “Landmark”, faturonte rreth 2 miliardë lekë nga këto kompani të oligarkëve. A është kjo, Lulzim Basha, gjoja që ti u vendos kompanive, për të mos ua përmendur emrin këtu në parlament? Unë mendoj që po! Lulzimi, përpara se të marrë përsipër të drejtë gjatë të vëllezërit e secilit prej nesh, te kunetërit e secilit prej nesh, duhet të sqarojë ai i pari marrëdhënien e kunatit të tij me të gjitha kompanitë e oligarkëve, pastaj të vijë këtu në

Kuvend dhe të bëjmë çdo lloj ligji. Por nuk mund të bësh ligj ti, Lulzim, në ato hotele, sallat e të cilëve nuk dihet se kush t’i paguan, një tur turistik gjithë shtatorin pa ditur ende se kush paguan dhe si paguhet.

Sa për luftën kundër oligarkëve, kundër përfshirjes së kriminalitetit, nuk ka asnjë përgjigje tjetër më të mirë se Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Prokuroria Speciale Antikorrupsion. Janë të dyja këto instrumente, të cilat reforma në drejtësi prej ditës së parë i ka planifikuar si instrumentet më të forta për të vendosur ligjin, për të bërë transparente të gjitha llojet e kontratave, të gjithë llojet e tenderave dhe të gjitha abuzimet në gjithë këta vjet.

Kolegë deputetë, dua edhe një herë t’ia nënvizoj kërkesën tonë ministrit të Bujqësisë, por edhe ministrive të tjera të përfshira, në lidhje me tokat e dhëna me qira gjithë këta vjet. Ne duhet të bëjmë një audit të plotë dhe sigurisht të gjitha ato që nuk janë shfrytëzuar, nuk janë dhënë në përdorim, nuk kanë krijuar vende pune, nuk kanë dhënë prodhim, duhet t’ia rikthejmë shtetit, me qëllim që shteti më pas, në mënyrë transparente, t’i rivendosë në funksion të ekonomisë së vendit.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Këtu përfundon lista e diskutantëve të regjistruar më parë. Në bazë të nenit 74, paragrafi 2, të Rregullores kalojmë në shprehjen në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputeti Fadil Nasufi.

Fadil Nasufi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Me ndryshimet dhe shtesat që do të miratojmë sot në ligjin për dhënie me qira të tokës bujqësore, ne do të çojmë më tej misionin tonë për zhvillimin e bujqësisë dhe të fshatit, duke i dhënë zgjidhje me mekanizma dhe instrumente ligjore atyre çështjeve, që janë potenciali i mundshëm dhe i pashfrytëzuar në sektorin e bujqësisë, agropërpunimit dhe turizmit. Programi i qeverisë “Rama” hapi një faqe të re për zhvillimin e bujqësisë, si një degë e rëndësishme e ekonomisë së vendit për punësim, për ushqim, për eksportet shqiptare, për rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe të familjeve të tyre

dhe për një reformë të plotë, që konsiston në nxjerrjen nga prapambetja që shënoi bujqësia dhe fshati gjatë viteve të tranzicionit.

Ky program është fokusuar në shtrirjen e modelit tonë të rilindjes urbane edhe në zonat rurale dhe synon një qasje të integruar për zhvillimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve, si dhe të turizmit. Gjatë këtij viti ka filluar projektimi dhe modelimi i projekteve të harmonizuara për “100 fshatrat” me potencial dhe interes turistik në të gjithë Shqipërinë. Gjatë këtyre 5 vjetëve që jemi në qeverisje kemi bërë një transformim të thellë edhe në sektorin e bujqësisë. Në mandatin e parë dyfishuam sipërfaqen e tokës që ujitet, në 225 hektarë dhe pas vitit 2017 janë shtuar edhe 22 mijë hektarë të tjerë, ndërsa gjatë vitit 2018, në fondin prej 23 milionë eurosh të Bankës Botërore, shtohen edhe 7 skema në sistemin e ujitjes.

Qeveria fuqizoi me mjete, ekskavatorë dhe fadroma 61 bashkitë e vendit, për rritjen e aftësisë ujtëse dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese. U rrit rimbursimi i TVSH-së nga fermerët nga 6% në 20%, u lehtësuan taksat për imputet bujqësore, makineritë dhe investimet në agrobiznes. Kemi filluar në rrugë të pakthyeshme procesin e formalizimit në sektorin e bujqësisë nëpërmjet dhënies së aktit të marrjes së tokës në pronësi, regjistrimit të pasurisë, pajisjes me NIPT të fermerëve, mbështetjes me grant e subvencione dhe kreditimit të aktivitetit bujqësor.

I dhamë zgjidhje funksionalizimit të çështjeve të shërbimeve në sektorin e bujqësisë, duke ia kaluar kompetencat e menaxhimit pushtetit vendor dhe po vijojmë me plotësimin e rritit të grumbullimit të produkteve bujqësore në çdo zonë; po marketojmë produktet shqiptare, duke synuar certifikimin e tyre ndërkombëtar, si dhe po modernizojmë tregjet, duke i dhënë fund një tradite sa kaotike, aq edhe primitive, një antivlerë të vërtetë që demonstrohej në këtë fushë.

Nga viti në vit jemi duke shkuar drejt formalizimit të ekonomisë bujqësore, po rrisim konkurrueshmërinë, kemi ndaluar barbarinë ndaj mjedisit, si dhe jemi duke rritur financimet në sektorin jetik, për të cilin jam duke folur, i cili parashikon 25,5 miliardë lekë deri në fund të mandatit. Bujqësia dhe fshati kanë potencial dhe përdorin gati 50% të GDP-së. Sot ky sektor ende

prodhon rreth 20% të GDP-së, çka lidhet me çështjet e fragmentarizmit të tokës, me mosshfrytëzimin e gati 8% të tokave djerrë, me produktivitetin e ulët dhe me të gjitha sfidat që e përballi tranzicioni fermerin, i cili pothuajse për 20 vjet u ndie i braktisur nga shteti. Përveç anomalive që solli ligji nr. 7501 dhe menaxhimi privat i ekonomisë bujqësore, fermerët janë dëshmitarë të shpërdorimit të fondeve publike për bujqësinë nga qeveria e PD-së dhe aleatët e saj agraro-LSI-stë, janë dëshmitarë të klientelizmit politik në financimin e skemave mbështetëse për bujqësinë, për zaptimin e paligjshëm të tokave dhe për kontratat e manipuluar të përfitueshmërisë, për financimet në agrobiznes.

Aq shije të hidhur ka lënë ky model korruptiv, saqë ende ndeshim mosbesim dhe hezitim në çdo risi që po implementojmë në programin tonë për bujqësinë dhe fshatin. Mjafton t’u referohem shembujve për qarkun e Beratit, shembuj që na i solli edhe deputeti Taulant Balla.

Fondet e AZHBR-së për 7 subjekte me vlerë nga 80 mijë deri në 150 mijë euro u dhanë në mënyrë klienteliste. Objektet kanë ndërruar destinacion, ku tjetër është përfituesi i skemës së financimit dhe tjetër është poseduesi i pronës. Në kohën kur qeveria “Rama” paraqiste programin në parlament më 11 shtator 2017, ish-ministri i Bujqësisë nënshkroi 5 kontrata të dhënies së tokave me qira disa klientëve politikë të partisë së tij.

Ligji nr. 8318 i dhënies së tokave shtetërore me qira ka filluar të zbatohet që nga vitit 1998 dhe për 20 vjet janë nënshkruar mijëra kontrata. Ashtu siç ka përfitues të rregullt dhe zhvillues të këtyre aseteve, ka edhe shumë abuzime dhe kontrata të paligjshme. Përveç klientelizmit politik të përfituesve, ka parregullsi dokumentacioni, që do të thotë se përfituesi ka më shumë tokë faktike dhe më pak tokë të shënuar në kontratë. Mospërputhja sjell mbivendosje dhe shmangie nga detyrimi për të paguar edhe qiranë.

Në fakt, në inventarin e tokave shtet figurojnë sipërfaqe të konsiderueshme të lira, por në terren nuk ka tokë të lirë, pasi ajo është zaptuar. Për shembull, në njësinë Otllak figurojnë 485 hektarë tokë e lirë, por ajo është e zaptuar tërësisht dhe punohet, prandaj kjo çështje

duhet të mbikëqyret dhe të zgjidhet, pasi po gjeneron jo vetëm informalitet, por edhe konflikt të trefishtë midis zaptuesit të radhës, shtetit dhe tendencës për t'ia hequr zaptuesit dhe për t'ia dhënë një tjetri me qira. Ne nuk e kemi sfidën me opozitën, por e kemi me këto realitete dhe me gjithçka për të cilat na kanë votuar dhe na kanë besuar njerëzit.

Panorama e mësipërme dhe vizioni ynë për të nxitur financimet në bujqësi, për ndërtimin e linjave të prodhimit, për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, për agroturizmin dhe të tjera, na sjellin natyrshëm në ndryshimet dhe shtesat që i duhen bërë ligjit nr. 8413, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”.

Duke u nisur nga relacioni i paraqitur, sqarimet që na dha ministri dhe zëvendëskryeministrja, si dhe diskutimet shteruese që bënë kolegët që morën fjalën për këtë projektligj, u bëj thirrje të gjithë deputetëve ta miratojmë projektligjin, sepse i jep mundësi konkretizimit të programit të qeverisë në fushën e bujqësisë dhe të turizmit, si dhe nxit sipërmarrjen dhe biznesin për të realizuar ndërtime në kushte specifike, të nevojshme, në përputhje me ligjin e planifikimit të territorit, në territorin ku gjendet toka, objekt i qiradhënies.

Qiramarrësit në ofertat e paraqitura, të shoqëruara me planet e biznesit të tyre, kanë mundësi të kryejnë investime në sistemimin, ujitjen, kullimin e tokave, objekt i qiradhënies, por edhe në linjat e prodhimit, të përpunimit të agrobiznesit dhe të turizmit, ku aktualisht ka shumë oferta, të cilat do të bëhen efektive me shtesat që ne po i bëjmë këtij projektligji. Ndryshimet në projektligj do të zgjidhin kthimin e tokës bujqësore në tokë truall dhe do të rregullojnë marrëdhëniet qiramarrës-qiradhënës.

Besoje se në bazë të ofertës së paraqitur, ky ligj do të gjejë mbështetje të fortë të fermerët dhe do t'i japë zgjidhje programit tonë për rilindjen rurale dhe për zhvillimin e bujqësinë.

Meqenëse fola në emër të grupit, dua të ngre edhe dy probleme që lidhen me zonën e Beratit.

Së pari, jo vetëm Ministria e Bujqësisë, por e gjithë qeveria urgjentisht duhet të gjejnë fondet për të bërë rehabilitimin e rrugës Poshnjë-Roskovec, sepse aty ndodhet jo vetëm një

komunitet i qëndrueshëm me mbi 20 mijë banorë, por edhe epiqendrat e prodhimit dhe model i investimit në bujqësi, siç janë Kutallia dhe Poshnja, të cilat kanë rreth 530 hektarë serra dhe eksportojnë mbi 50 mijë tonë prodhim çdo vit. Kjo sasi nga vit në vit dyfishohet.

Me të njëjtën vëmendje kërkoj të rishikohet edhe çështja e riorganizimit të drejtorive rajonale, pasi të gjitha drejtoritë rajonale po ia humbasin funksionin administrativ Beratit dhe po e kthejnë në drejtori të nivelit të dytë, pasi po përqendrohen në Korçë dhe në Elbasan.

Së treti, me të njëjtin përkushtim duhet t'i drejtohem programit të “100 fshatrave” dhe skemave të zhvillimit të infrastrukturës në fshat që t'u rikthejmë besimin banorëve të fshatrave në zonat e braktitura, të cilët presin urgjentisht investime dhe mbështetje konkrete në programet e infrastrukturës, të shërbimeve dhe të zhvillimit të ekonomisë bujqësore.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Këtu mbyllet diskutimi në parim për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar”.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës të projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”. Ky projektligj është nismë e ministrit të Financave.

Nuk e di nëse kolegët kanë pyetje për këtë projektligj. Nëse nuk ka pyetje, do të doja t'ju vija në dijeni se në listën e deputetëve diskutantë nuk ka emra të regjistruar.

Sipas Rregullores, në përfundim kalojmë në diskutimin në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste do të shprehet deputetja Tatjana Pirro Nurçe.

Fjala për ju, zonjë.

Tatjana Pirro Nurçe – E nderuar drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë ofron një mbrojtje të pronësisë industriale të përafuar me *acquis communautaire*, duke përmbushur një prej angazhimeve të nenit 73 të

Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, kapitulli VII “E drejta e pronësisë intelektuale.

Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar” solli përmirësime për sa i përket përafrimit me direktivat e BE-së, ngritjes së Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut, duke bërë rregullime të nevojshme për implementimin e marrëveshjes në fushën e patentave, si dhe duke saktësuar e reflektuar problemet dhe gabimet e identifikuara gjatë zbatimit të ligjit në praktikë.

Shqipëria është anëtare e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare të fushës së pronësisë industriale, por ajo ende nuk ka ratifikuar disa marrëveshje të rëndësishme. Në korrik parlamenti ka ratifikuar marrëveshjet e Lokarnos dhe atë të Vjenës. Ratifikimi i marrëveshjes së Gjenevës “Për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës” do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve në këtë fushë.

Akti i Gjenevës mundëson regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës dhe lejon hyrjen e organizatave ndërqeveritare në marrëveshjen e Lisbonës. Ai zhvillon më tej kuadrin ligjor të sistemit të Lisbonës, një sistem që ndihmon në promovimin global të shumë produkteve. Aktualisht janë regjistruar 11 tregues gjeografikë dhe emërtime origjine me prejardhje nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Të tilla produkte paraqesin rëndësi të veçantë për Shqipërinë, pasi regjistrimi kombëtar e më tej ai ndërkombëtar, ndikon në rritjen e vlerës së këtyre produkteve tradicionale, në gjallërimin e zonave rurale, në ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore e gastronomike, si dhe ofron mundësinë e njohjes së produkteve karakteristike shqiptare në tregjet e huaja.

Nënshkrimi i këtij akti do të ishte në interesin e mbajtësve të së drejtave për emërtimet e origjinës, të cilat me anë të një aplikimi të vetëm do të shkurtojnë kohë dhe kosto për mbrojtje të vendeve të tjera.

Aderimi në këtë akt sjell disa përfitime: bën shumë ndryshime dhe përmirësime për modernizimin e sistemit të regjistrimit të treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës; siguron të drejta, që kombinojnë elementet e mbrojtjes së markave të njohura dhe mbrojtjes së treguesve gjeografikë.

Vendet anëtare sigurojnë mjete ligjore për të parandaluar një përdorim të paautorizuar të treguesve gjeografikë në tri situata, si në rastet kur mallrat janë të njëjta me ato për të cilat është aplikuar për treguesit gjeografikë; ndonjë praktikë që mashtron konsumatorët në lidhje me origjinën e vërtetë apo natyrën e mallrave, përfshirë edhe imitimin e treguesit gjeografik apo emërtimit të origjinës; shërbimet që nëpërmjet përdorimit lejojnë të përdoret reputacioni i treguesit gjeografik apo emërtimet e origjinës.

Niveli i lartë i mbrojtjes që siguron marrëveshja e TRIPS-it “Për verërat dhe pijet alkoolike” është afër standardit të marrëveshjes së Lisbonës të vitit 1958, ndoshta edhe më tepër tani me aktin e Gjenevës. Çdo palë kontraktuese e marrëveshjes përcakton një subjekt, i cili është përgjegjës për administrimin e këtij akti në territorin e tij dhe komunikimet me Byronë Ndërkombëtare.

Sipas këtij akti dhe këtyre rregulloreve, pala kontraktuese njofton emrin dhe të dhënat e kontaktit të këtij autoriteti kompetent në Byronë Ndërkombëtare, siç përcaktohet në rregullore.

Byroja Ndërkombëtare mban një regjistër ndërkombëtar, ku regjistron regjistrimet ndërkombëtare të kryera sipas këtij akti, sipas marrëveshjes së Lisbonës dhe aktit të vitit 1968, ose sipas të dyjave dhe të dhënave që lidhen me këto regjistrime ndërkombëtare.

Regjistrimet ndërkombëtare janë të vlefshme për një kohë të pacaktuar në kuptim që mbrojtja e një emërtimi të regjistruar të origjinës, ose treguesit gjeografikë nuk kërkohen më nëse emri i emërtimit të origjinës ose i treguesve gjeografikë nuk është i mbrojtur në palën kontraktuese të origjinës.

Kontributi që duhet të paguajë DPPI-ja, nëse aderohet në këtë akt, varet nga një sërë faktorësh. Konkretisht do të merret parasysh shuma e deficitit të parashikuar gjatë dyvjeçarit, nëse do të ketë, numri i vendeve anëtare në marrëveshje, klasa e kontributeve të cilës i përket Shqipëria, numri i regjistrimeve kombëtare që kanë vendet në aktin e Gjenevës, në ndryshim nga marrëveshja e Lisbonës, si dhe mënyra se si vendet anëtare të unionit të Lisbonës vendosin të përdorin kontributet.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Nurçe!

Mbyllet diskutimi në parim për projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”.

Zoti Balla ka kërkuar fjalën.

Taulant Balla – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, kërkoj 15 minuta pushim për mbledhje grupi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Do të bëjmë 15 minuta pushim. Ndërkohë, kolegët të bëhen gati për votim.

(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Të futet media!

Rifillojmë seancën për votimin e projektligjeve.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

71 deputetë janë prezentë.

Fillojmë me votimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror””.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

71 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen, me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

71 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8318, datë 1.4.1998 “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar””.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

71 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen, me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

71 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji.

Kalojmë në projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”.

Mbështetur në nenet 121 dhe 122 të Kushtetutës, kërkohet shumicë absolute votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

71 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

71 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kemi projektvendimin “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar””.

Sipas nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores kërkohet shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Ju njoftoj se Këshilli i Ministrave ka kërkuar shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 24 SHTATOR 2018

në ligjin nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar””.

Gjithashtu, sot është depozituar në Kuvend edhe një nismë e deputetëve që e amendon këtë ligj, kështu që të dyja nismat do të shqyrtohen së bashku.

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 28 të Rregullores, shprehet një folës pro dhe një kundër.

E dëshiron njeri fjalën? Nuk e dëshiron.

Projektvendimi u është shpërndarë deputetëve. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut është komision përgjegjës.

Amendamentet që mund të ketë për çështje të ndryshme të depozitohen deri në datën 2 tetor dhe shqyrtimi në seancë plenare të bëhet më 11 tetor.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

71 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Nga votimet e bartura, siç e kemi bërë me dije, për mungesë kuorumi vazhdon të mbetet pa u votuar projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””, si dhe projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Këtu mbyllet seanca për ditën e sotme.

Seanca tjetër do të njoftohet me mjetet elektronike.

Faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 12:30.)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Alket Hyseni

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**